



KOMPANIJA KOSOVARE PËR DISTRIBUIMIN E FURNITIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKË SËLA  
KOSOVO ELECTRIC CITY DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY J.S.C.  
KOSOVSKO PREDZECEZA ZA DISTRIBUJU I SNABDHANJE ELEKTRONI E ENERGI

Ndertesa e Elektrokosovës  
Bulevardi Bill Clinton nr 3  
Prishtine 10000  
Republika e Kosovës

Elektrokosova Building  
Bill Clinton Boulevard no.3  
Prishtina 10000  
Republic of Kosovo




KEDS - SH.A.

Nr. 96 Dl. 22.11.2022  
HQ 1

Ymer Fejzullahu  
Kryesues i Bordit të ZRRE-së

Alpin Dogan  
Kryeshef Ekzekutiv, KEDS sh.a.



22 Nëntor 2022

Lënda: Propozimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale për periudhën e tretë rregullative (2023-2027)

I nderuar z. Fejzullahu,

Përmes kësaj shkrese, po ju dërgojmë Propozimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale për periudhën e tretë rregullative në përputhje me Rregullën për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për të hyrat e OSSH-së), dhe njoftimin e Zyrës së Rregulatorit për Energji (ZRRE) për hapje të procesit sipas orarit indikativ të ZRRE-së.

Krija energetike, rritja e çmimeve dhe inflacioni pritet të ndikojnë negativisht në vitet në vazhdim, andaj për të shmangur çdo rrezik i cili do të dëmtonte stabilitetin, qëndrueshmërinë dhe operimin efikas të OSSH-së, kërkojmë nga ZRRE që të konsideroj propozimin e OSSH-së.

Për shkak të rëndësisë së madhe të këtij procesi, OSSH-ja është e hapur dhe e gatshme për diskutime të mëtejshme kurdo që është e nevojshme.

Me respekt,

Alpin Dogan  
Kryeshef Ekzekutiv

Shtojcat:

Propozimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale për periudhën e tretë rregullative



Ndertesa e Elektrokosovës  
Bulevardi Bill Clinton nr 5  
Prishtina 10000  
Republika e Kosovës

Electrokosova Building  
Bill Clinton Boulevard nr 5  
Prishtina 10000  
Republic of Kosovo



## Propozimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale për periudhën e tretë rregullative (2023-2027)

Tetor, 2022



Ndërtesa e Elektrokosovës  
Bulevardi Bill Clinton nr 5  
Pristina 10000  
Republika e Kosovës

Elektrokosovë Building  
Bill Clinton Boulevard nr 5  
Prishtina 10000  
Republic of Kosovo



## Përmbajtja:

1. Hyrje.....	3
2. Metodologjia e përcaktimit e të hyrave të lejuara maksimale .....	3
3. Kostot e sistemit shpërndarjes .....	3
3.1. Kostot kapitale .....	4
3.1.1. Baza e Aseteve të Rregulluara .....	4
3.1.2. Zhvlerësimi.....	4
3.1.3. Kthimi i lejuar .....	5
3.2. Kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes.....	5
3.2.1. Opex bazë.....	5
3.3. Kostot e humbjeve .....	7
4. Të Tjera .....	8
4.1. Të hyrat jo-tarifore dhe kostot e përjashtuara .....	8
4.2. Obligimet ndaj Operatorit të Tregut dhe Operatorit të Sistemit.....	8
4.3. Përshtatjet e rregullta .....	9
5. Të hyrat e lejuara maksimale për periudhën 2023-2027 .....	9



Ndërtesa e Elektrokosovës  
Bulevardi Bill Clinton nr 5  
Prishtinë 10000  
Republikë e Kosovës

Elektrokom v.d. Prishtina  
Bill Clinton Boulevard no 5  
Prishtina 10000  
Republika e Kosovës



## 1. Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) duke u bazuar në përgjegjësit e dhëna me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë si dhe konform Rregullës për të Hyrat e Operatorit Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) ka filluar shqyrtimin e tretë periodik për tarifat shumëvjeçare (MYT3) për të vendosur të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) të licencuarve OST/OT dhe OSSH për periudhën 1 prill 2023 deri më 31 mars 2028.

Operator i Sistemit të Shpërndarjes ka përgatitur Propozimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale për peridhën e tretë rregullative në përputhje me Rregullën për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për të hyrat e OSSH-së), dhe njoftimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për hapje të procesit sipas orarit indikativ të ZRRE-së.

Kapitujt vijues jepin shpjegimet dhe arsyetimet e nevojshme për të gjitha kostot e kërkua, të cilat janë të domosdoshme për operimin e duhur të sistemit të shpërndarjes.

## 2. Metodologjia e përcaktimit e të hyrave të lejuara maksimale

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjëse për operimin dhe investimin në rrjetin e shpërndarjes, në mënyrë që të shpërndajë energji elektrike drejt tek përdoruesit e rrjetit. Duke qenë se OSSH-ja është kompani e rregulluar, ZRRE-ja vlerëson të hyrat e lejuara bazuar në koston operative, zhvlerësim dhe një normë të drejtë kthimi, së bashku me kostot e energjisë dhe kostot tjera përcjellëse.

Të hyrat e lejuara maksimale janë të hyrat e mbuluara nga OSSH përmes tarifave për kryerjen e shërbimeve të sistemit të shpërndarjes si dhe gjitha të hyrat tjera të përcaktuara nga ZRRE. Të hyrat e lejuara maksimale përcaktohen për një periudhë pesëvjeçare me mundësi për të kryer përshtatjet vjetore çdo vit për dallimet në mes kostove të lejuara dhe të realizuara si dhe të hyrat që janë kontrollit të OSSH-së.

## 3. Kostot e sistemit shpërndarjes

Kostot e shërbimit të OSSH-së janë kategorizuar si kosto kapitale të lidhura me vlerën e bazës së aseteve të rregulluara dhe kostot operative. Kostot kapitale janë shuma e kostove të zhvlerësimit dhe kthimit i lejuar i kapitalit, ndërkohë që kostot operative mund të përfshijnë edhe kostot e humbjeve të rrjetit, ose humbjet mund të trajtohen si një kategori e veçantë e kostove. Të gjitha këto kategori të kostove i nënshtrohen vlerësimit dhe njohjes nga ZRRE-ja si kosto të arsyeshme dhe mbulohen nëpërmjet tarifave të rrjetit.



### 3.1. Kostot kapitale

#### 3.1.1. Baza e Aseteve të Rregulluara

Koncepti i Bazës së Aseteve të Rregulluara u zhvillua në Britaninë e Madhe për të ofruar siguri për investitorët e ndërmarrjeve të privatizuar të rrjetit duke përcaktuar parimet për llogaritjen e kufirit të çmimeve. Koncepti i RAB synon të sigurojë rikuperimin e plotë të investimit kapital të investitorit me një nivel të drejtë kthimi. Në këtë mënyrë, RAB shërben si një mbrojtje për investitorët, veçanërisht në ndërmarrjet e rrjetit të privatizuar, pasi mbron investimet e tyre që të mos trajtohen në mënyrë të padrejtë.<sup>1</sup>

Baza e aseteve të rregulluara është vlerë e rregulluar e shumës së aseteve fiksë të përdorura dhe të dobishme në ofrimin e shërbimeve të sistemit të shpërndarjes dhe ndahet në kategori të ndryshme të aseteve.

Gjatë periudhës së dytë rregullative u lejuan 131.4 milion euro investime, nga të cilat rreth 50% janë investime kapitale në nivelin e ultë të tensionit dhe 35% në tensionin e mesëm. Sidoqoftë, periudha e dytë rregullative u karakterizua me disa ngjarje të pazakonta, siç janë pandemia dhe kriza energetike, të cilat ishin jashtë kontrollit të Operatorit te Sistemit të Shpërndarjes dhe drejtpërsëdrejti ndikuan në operimet ditore të OSSH-së. Diferenca ndërmjet projekteve të lejuara dhe atyre të aprovuara do të jetë subjekt i përshtatjeve, të cilat si të tillë janë përfshirë në kalkulimet e të hyrave të lejuara për periudhën e tretë rregullative.

Sa i përket periudhës së tretë rregullative, OSSH tashmë ka dërguar për aprovim projektet invenstive 5 vjeçare, në vlerë prej 156.4 milion euro. Objektivat primare të Planit Investiv të OSSH-së i adresohen çështjeve si sigurimi i qëndrueshmëri dhe kualitativ i furnizimit me energji elektrike, mbështetja e rritjes së ngarkesës, pajtueshmëria me standartet e operimeve dhe perfomancës, zvogëlimi i humbjeve teknike dhe ato jo-teknike, dhe rehabilitimi dhe modernizimi i matjes së energjisë elektrike.

Të njëjtit janë përdorur për të shtuar bazën e aseteve të rregulluara e me qëllim të kalkulimit të zhvlerësimit dhe kthimit për periudhën e tretë rregullative.

#### 3.1.2. Zhvlerësimi

Kostot e lejuara të zhvlerësimit llogariten në mënyrë lineare si funksion i jetëgjatësisë ekonomike apo teknike të aseteve dhe bazës së aseteve të rregulluara për kategoritë ndryshme të aseteve.

Me qëllim të kalkulimit të zhvlerësimit është përdorur kategorizimi dhe jetëgjatësia e aseteve sipas parametrave të aprovuara nga rregulatori përmes vendimit V\_1020\_2018. OSSH gjithashtu ka përdorur

<sup>1</sup> Dalibor Muratović, Raporti Final “Asistencë Teknike për Zhvillimin e Udhëzimeve të Politikave për tarifat e Rrjetit të Shpërndarjes”, Nëntor 2017



Ndertesa e Elektrokosovës  
Bulevardi Bill Clinton nr 5  
Prishtina 10000  
Republika e Kosovës

Elektrokosova Uitdeling  
Bill Clinton Boulevard nr 5  
Prishtina 10000  
Republiek van Kosovo



modelin e ZRRE-së përmes së cilës janë kalkuluar dhe aprovuar zhvlerësimet për periudhën e dytë rregullative.

Marrë parasysh si më sipër, kostot e zhvlerësimit për periudhën e tretë rregullative janë llogaritur mesatarisht si 22 milion euro në vit. Marrë parasysh se plani i investimeve është subjekt i aprovimit nga ZRRE-ja, çfarëdo përshtatje eventuale duhet të reflektohen në kalkulimet e zhvlerësimit për periudhën e tretë rregullative.

### 3.1.3. Kthimi i lejuar

Kthimi i lejuar në kostot e kapitalit llogaritet si funksion i bazës së aseteve të rregulluara dhe mesatares së ponderuar të kostos së kapitalit.

OSSH në propozimet e tij ka kërkuar rritjen e Mesatares së ponderuar të kostos së kapitalit (WACC) krahasuar me periudhën e dytë rregullative, si rezultat i rritjes së parametrave të cilat përdoren në kalkulimin e WACC. Megjithatë, Bordi i ZRRE-së për periudhën e tretë rregullative 2023-2027 ka aprovuar Mesataren e ponderuar të kostos së kapitalit (WACC) në vlerë prej 7.69%, përkatësisht 0.6 pikë përqindje më të ultë sesa WACC-u i përdorur për periudhën e dytë rregullative.

OSSH gjatë kalkulimit të kthimit të lejuar për periudhën e tretë rregullative ka marrë parasysh nivelin e lejuar të WACC nga rregulatori për periudhën 2023-2027 dhe planin investiv 5 vjeçar. Duke përdorur modelin e ZRRE-së, kthimi i lejuar për periudhën e tretë rregullative rezulton të jetë mesatarisht 20 milion euro në vit.

## 3.2. Kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes

### 3.2.1. Opex bazë

Në kompanitë e rregulluara kostot operative dhe të mirëmbajtjes njihen nga Rregulatori si kosto të arsyeshme pasi që këto kosto mundësojnë ofrimin e shërbimeve nga kompanitë dhe mbajtjen e këtyre shërbimeve në një nivel të duhur. Në kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes (OPEX) përfshihen disa kategoritë kostove si: kostot e mirëmbajtjes, kostot operative dhe kostot tjera të cilat janë jashtë kontrollit të OSSH.

Përgjatë viteve shpenzimet operative të OSSH-së dhe numri i shërbimeve të ofruar janë rritur shumë. Analizë e hollësishme e shpenzimeve operative (OPEX) është realizuar vetëm në vitin 2011 kur janë shqyrtaar dhe vlerësuar kostot e periudhës së parë rregullative. Që atëherë, me gjithë disa ndryshime të vogla në shpenzimet operative, të cilat ishin kryesisht kërkesa ligjore, ZRRE ka përdorur nivelin bazë të OPEX-it edhe gjatë periudhës së dytë rregullative.

OSSH ka arritur efikasitet ndër vite, ku në periudhën e parë rregullative ka zvogëluar shpenzimet operative për 11% në mënyrë kumulative, ndërsa në periudhën e dytë rregullative edhe 8% të tjera. Është e



Ndertesa e Elektrokosovës  
Bulevardi Bill Clinton nr 5  
Pristina 10000  
Republika e Kosovës

Elektrokoosive Building  
Bill Clinton Boulevard no. 5  
Prishtina, 10000  
Republika e Kosovës



rëndësishme të theksohet se maksimizimi i eficiencës përtej mundësive te OSSH-së mund të ndikoj negativisht në cilësinë e shërbimeve. Cilësia e ofrimit të shërbimeve nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes pa dyshim që ka kosto të lartë marrë parasysh se kërkohen programe specifike dhe të specializuara të sistemit operativ.

Numri i konsumatorëve është vazhdimisht në rritje nga 470,000 konsumatorë aktiv në vitin 2013, numri është rritur mbi 670,000 konsumatorë aktiv, e cila ka rezultuar edhe me rritjen e shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve për këta konsumatorë.

Rritja e numrit të madh të konsumatorëve ndër vite po ashtu ka ndikuar në rritjen e volumit të punëve për punonjësit e OSSH. Volumi i rritur i punës, së bashku me një ambient të punës shumë stresues dhe dallimi madh në paga në mes të OSSH dhe punëtorëve në sektorit publik të energjisë elektrike, ka rritur lëvizjet e punëtorëve të kualifikuar dhe respektivisht OSSH-ja po përballet me mungesë të stafit të kualifikuar. OSSH-ja në vazhdimësi ka kërkuar reflektim të pagave për punonjësit në të njëjtin nivel me operatorët tjera në industrinë e ngjashme mirëpo kjo kërkesë nuk ka gjetur mbështetjen e nevojshme.

Pagat përbëjnë 80% të totalit të OPEX dhe shumica e kostove të tjera brenda OPEX janë jashtë kontrollit të OSSH-së, andaj aplikimi i normës së efikasitetit në nivelin e pagave e pérkeqëson më tej gjendjen. Kriza energetike si pasojë e luftës në Ukrainë ka ndikuar në rritjen e kostove të shërbimeve dhe të mirave materiale. Për shkak të krizës energetike norma e inflacionit vazhdon të rritet për çdo muaj, duke rritur indeksin e kostos së jetesës. Vetëm në shtator të këtij viti sipas Agjencisë së statistikave të Kosovës indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ka arritur në 12.7%.<sup>2</sup> Kjo duhet të shërbej si bazë për ngritjen e pagave për kompaninë, meqenëse nuk ka dyshim se rritja e indeksit të çmimeve të konsumit pritet të rëndojoj edhe me tej buxhetin e punonjësve të kompanisë e cila më pastaj do të rezultojë me pakënaqësi dhe presion ndaj kompanisë për rritje të pagave.

Gjatë vitit 2022, OSSH është përballur me protesta për shkak të kërkesave për rritje të pagave, të cilat vlerësohen si më të ulëtat në sektor. Në fillim të vitit 2023 janë paralajmëruara protesta të radhës në rast të mos-reflektimit të rritjes së pagave. Rritja e pagave dhe ndihmave në sektorin publik, protestat e paralajmëruara edhe nga KEK gjenerimi, vetëm se kanë shtuar argumentet e punëtorëve. Mos-reflektimi i nivelizimit të pagave te OSSH-se me sektorin e energjisë elektrike në vend rrezikon dukshëm qëndrueshmërinë operative të OSSH-së, të cilët po përballen me largim të vazhdueshëm të punëtorëve profesional. Kjo e fundit ka ndikim te drejtpërdrejtë edhe në cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Ngjashëm, kostot e mirëmbajtjes përfaqësojnë vetëm koston për çmimin dhe materialet, pasi pjesa më e madhe e punës bëhet përmes punonjësve të brendshëm, kostot e të cilëve tashmë janë përfshirë në linjat e pagave. Si rezultat, të dyja këto janë jashtë kontrollit të OSSH-së. Të dhënat nga Eurostat tregojnë se ndërmjet viteve 2000-2021 çmimet në BE janë rritur për 46%<sup>3</sup> në përgjithësi. Norma e inflacionit ne gusht

<sup>2</sup> Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit, Agjencia e statistikave të Kosovës, fq.4

<sup>3</sup> Eurostat 2022, [https://ec.europa.eu/eurostat/cache/digpub/european\\_economy/bloc-1c.html?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/cache/digpub/european_economy/bloc-1c.html?lang=en) (vizituar se fundi me 27.09.2022)



Ndertesa e Elektrokosovës  
Bulevardi Bill Clinton nr.5  
Prishtina 10000  
Republika e Kosovës

Elektrokosova Building  
Bill Clinton Boulevard no. 5  
Prishtina 10000  
Republic of Kosovo



të vitit 2022 në zonën e BE-se arrii në 9.1% krahasuar me muajin korrik të vitit 2022 prej 8.9%<sup>4</sup> që jep sinjale të rritjes së vazhdueshme të çmimeve.

Prandaj, në këto rrethana rreziku i qëndrueshmërisë së operimeve të OSSH është më se evident nëse ZRRE gjatë vlerësimit të kostove operative dhe të mirëmbajtjes nuk merr parasysh faktet e lartpërmendura, veçanërisht marrë parasysh edhe faktin se Bordi i Zyrtërës së Rregullatorit të Enerjisë ka vendosur një cak të eficiencies së shpenzimeve operative prej 1.5% në baza vjetore.

Gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale për periudhën e tretë rregullative, OSSH ka marrë parasysh numrin e punëtoreve dhe për të njëjtët gjatë kalkulimit të pagave ka vlerësuar një rritje te domosdoshme të nivelit të pagave, me qëllim të reflektimit të kostove aktuale në sektorin e energjisë (krahasuar me operatoret e tjera). Gjithashtu gjatë kalkulimit të OPEX-it përfundimtar janë reflektuar çmimet aktualet të ofrimit të shërbimeve si: mirëmbajtja, sigurimi i aseteve, gazi etj. Si përfundim, OPEX i domosdoshëm për operim të qëndrueshëm të OSSH-së për periudhën e tretë rregullative është rreth 30 milion euro.

### 3.3. Kostot e humbjeve

Operatori i sistemit të shpërndarjes është pjesëmarrës në treg vetëm për blerje të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe megjithëse është përgjegjës për blerjen dhe shitjen e energjisë së balancimit, këto të fundit nuk janë të përfshira në tarifat e tij. Energjia elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjet normalisht blihet në një procedurë të bazuar në treg.

Marrë parasysh se Furnizuesi me Shërbim Universal ka prioritet në blerjet nga prodhimi i KEK-ut, varësia e Operatorit sistemit të shpërndarjes nga importi është e lartë. Si rezultat, kostot e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të shpërndarjes së energjisë elektrike ndikohen shumë nga çmimet në tregjet evropiane të energjisë elektrike.

Çmimet e energjisë elektrike në tregjet ndërkombëtare që nga gjysma e dytë e vitit 2021 kanë qenë shumë të larta dhe jo stabile. Fillimi i arsyes së kësaj rritje ka qenë rimëkëmbja jashtëzakonisht e shpejtë e ekonomisë globale pas pandemisë Covid, e cila ka rezultuar me kërkesë të madhe për energji, ndërsa hox të madh kanë marrë pas fillimit të luftës në mes Ukrainës dhe Rusisë, duke shënuar vlerat më të larta në dekadat e fundit. Si rezultat i kësaj OSSH gjatë vitit 2021 dhe 2022 është përballur me kosto enorme për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve.

Në Raportin i Progresit për vitin 2022<sup>5</sup>, është përmendur se vonesat në njohjen e kostove faktike të humbjeve në tarifat e rrjetit shkaktoi një krizë të rëndë likuiditeti për OSSH-të e eksposuara ndaj çmimeve të tregut, duke rrezikuar aftësinë e tyre për të ofruar furnizim të besueshëm dhe të vazhdueshëm me

<sup>4</sup> Eurostat 2022 [https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Inflation\\_in\\_the\\_euro\\_area](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Inflation_in_the_euro_area) (vizituar se fundi me 27.09.2022)

<sup>5</sup> Komisioni Evropian, Raporti Progresit 2022, Bruksel 12.10.2022, fq. 110



Indresa e Elektrokomisionit  
Bulevardi Bill Clinton nr 5  
Prishtina 10000  
Republika e Kosovës

Elektrokomision Building  
Bill Clinton Boulevard no.5  
Prishtina 10000  
Republika e Kosovës



energji elektrike për konsumatorët. Madje edhe në njëren nga shkresat e publikuara nga Grupi Koordinues i Operatorëve të Sistemit të Shpërndarjes së Komunitetit të Energjisë "Ndiçimi i Krizës së Fundit të Energjisë në Funksionimin dhe Qëndrueshmërinë e Operatorëve të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Komunitetin e Energjisë" është përmendur se vonesa në njojen e kostove faktike të humbjeve në tarifat e rrjetit shkaktoi një krizë të rëndë likuiditeti për OSSH-të e ekspozuara ndaj çmimeve të tregut, duke rezikuar aftësinë e tyre për të ofruar furnizim të besueshëm dhe të vazhdueshëm me energji elektrike për konsumatorët.

Për të evitar përsëritjen e një skenari të tillë, e cila do të rrezikonte më tej qëndrueshmërinë financiare të OSSH-së, ZRRE-ja duhet të reflektoj saktësish kostot e parashikuara në bursat ndërkombëtare, të cilat deri në vitin 2025 nuk parashohin çmime të importit nën 300 €/MWh si mesatare vjetore në kohën e pikut<sup>6</sup>.

Sa i përket volumeve, të njëjtat janë në harmoni me energjinë e pritshme në hyrje të sistemit të shpërndarjes dorëzuar për shqyrtimin shumëvjeçar të bilancit të energjisë elektrike.

OSSH konform Rregullës për Çmimet e OSSH-së dhe vendimit të Rregulatorit për Energji ka aplikuar faktorin ndarës prej 50%, të cilat janë përshtatur në kalkulimet e të vrave të lejuara maksimale për vitin 2023.

#### 4. Të Tjera

Pjesë përbërëse e të vrave të lejuara maksimale (MAR) janë gjithashtu të hyrat jo tarifore, obligimet ndaj Operatorit të tregut dhe operatorit të sistemit të transmetimit, si dhe përshtatjet vjetore.

##### 4.1. Të hyrat jo-tarifore dhe kostot e përjashtuara

ZRRE-ja gjatë aprovimit të të vrave të lejuara maksimale i zbere të hyrat nga aktivitetet e parregulluara të kryera nga OSSH. Marrë parasysh se të njëjtat variojnë ndër vite, OSSH ka parashikuar të hyrat jo tarifore nga aktivitetet tjera të parregulluara bazuar në vlerësimet e periudhës së dytë rregullative.

Të njëjtit janë kosto të zbritshme nga të hyrat e lejuara maksimale dhe çdo ndryshim eventual i parashikimit të këtyre kostove nga të dhënat aktuale për vitin përkatës, janë subjekti i përshtatjeve gjatë përshtatjeve të rregulla vjetore.

##### 4.2. Obligimet ndaj Operatorit të Tregut dhe Operatorit të Sistemit

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes obligohet të paguaj tarifat e Operatorit të tregut (OT) dhe Operatorit të sistemit (OS), ashtu siç përcaktohen nga ZRRE për volumet e nevojshme për OSSH-në. Megjithëse këto kosto janë të bartshme, të njëjtit për qëllime të kalkulimit të MAR-it përfundimtar në ketë raport janë kalkuluar duke marrë për bazë çmimet aktuale. Çdo ndryshim ndërmjet çmimet aktuale dhe atyre të

<sup>6</sup> Parashikimi i tregut ndërkombëtar për energji elektrike HUDEX, <https://hudex.hu/en/market-data/power/daily-data#year> (reference e dt. 20.10.22)



Ndertesa e Elektrokosovës  
Bulevardi Bill Clinton nr 5  
Prishtina 10000  
Republika e Kosovës

Elektrokosovës Building  
Bill Clinton Boulevard no 5  
Prishtina 10000  
Republika e Kosovës



vlerësuara nga ZRRE-ja duhen të përdoren në raportin përfundimtar, para përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale për periudhën e tretë rregullative.

#### 4.3. Përshtatjet e rregulla

OSSH gjatë kalkulimit të MAR-it për periudhën e tretë rregulative ka aplikuar gjithashtu përshtatjet e rregulla vjetore, konform rregullës për çmimet e OSSH-së.

ZRRE-ja gjatë parashikimeve për vitin 2022, përkundër kërkesave të OSSH-së, ka paraparë si volume më të vogla të energjisë në hyrje të shpërndarjes, ashtu edhe çmim më të ultë krasuar me çminin mesatar vjetor. Duke marrë në konsideratë që edhe tarifat e reja janë reflektuar vetëm më 9 shkurt 2022, ka rezultuar një përshtatje pozitive e cila është reflektuar në kalkulimin e të hyrave të lejuara maksimale për vitin 2023.

Meqenëse viti 2022 njëherazi paraqet edhe mbylljen e periudhës se dytë rregullative, OSSH ka përshtatur gjithashtu vlerën e investimeve, përkatesisht vlerën e kthimit dhe zhvlerësimit. Marrë në konsideratë se përshtatjet e tilla i takojnë periudhës 5 vjeçare 2018-2022, përshtatjet janë aplikuar kalkulimeve të MAR-it përfundimtar për periudhën e tretë Rregullative.

### 5. Të hyrat e lejuara maksimale për periudhën 2023-2027

Pas prezantimit të të gjitha komponentëve dhe kostove të arsyetuara në seksionet e mëparshme, OSSH ka kalkuluar kërkesën për të hyrat e lejuara maksimale për periudhën e tretë rregullative 2023-2027, si në vijim:

Periudha e Tretë Rregullative

DSO	Unit	2023	2024	2025	2026	2027
Shpenzimet Operative	€000s	35,912	34,611	35,304	35,927	36,463
Zhvlerësimi	€000s	20,205	20,685	22,658	23,585	25,345
Kthimi	€000s	18,369	18,205	19,375	20,256	20,871
Blerjet	€000s	277,063	211,944	146,312	136,984	129,207
Të hyrat e përjashtuara	€000s	-3,500	-3,500	-3,500	-3,500	-3,500
Obligimet ndaj OT dhe OS	€000s	1,889	1,841	1,804	1,779	1,757
Përshtatjet	€000s	13,578	-3,759	-3,759	-3,759	-3,759
<b>Total</b>	<b>€000s</b>	<b>363,515</b>	<b>280,028</b>	<b>218,193</b>	<b>211,273</b>	<b>206,384</b>

Kërkesa e OSSH-së për të Hyrat e sipershënuara është me qëllim të operimit të qëndrueshëm të operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe ofrimit të shërbimeve cilësore për konsumatorët gjatë periudhës së tretë rregullative. Çfarëdo tendencë për të zgjeluar kërkesën e OSSH-së do të rrezikoj likuiditetin finanziar të OSSH-së dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike në përgjithësi.